



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 tetor 2015  
Nr. ref.: RK 849/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI35/15**

Parashtrues

**Sami Omura**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 341/2014, të 6 janarit 2015**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Sami Omura, me vendbanim në fshatin Greme, komuna e Ferizajt, i përfaqësuar nga z. Sabri Kryeziu, avokat.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 341/2014, (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 6 janarit 2015, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 shkurt 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit (Rev. nr. 341/2014, të 6 janarit 2015) të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 1, paragrafi 2 [Përkufizimi i Shtetit]; nenin 22 pika (7) [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 37, paragrafët 1 dhe 2 [E Drejta e Martesës dhe Familjes] dhe nenin 50, paragrafi 1 dhe 2 [Të Drejtatat e Fëmijës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejme: KDF).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 23 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI35/15, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI35/15 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova, dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 7 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai dokumentacion shtesë. Një kopje të kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI35/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015 dhe, me Vendimin nr. KSH. KI35/15, zëvendëskryetari Ivan Čukalović zëvendësoi gjyqtarin Altay Suroy në përbërjen e Kolegjit shqyrtues.
9. Më 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve në procedurë administrative**

10. Më 2 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës së bashku me bashkëshorten e tij parashtruan kërkesë për adoptimin e një fëmije të gjinisë mashkullore (lënda,

nr. 25-2337) në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: QPS në Ferizaj).

11. Më 13 maj 2011, QPS në Ferizaj i drejtohet me një kërkesë QPS në Malishevë, nëse kjo e fundit ka një fëmijë të gjinisë mashkullore në pritje për adoptim, pasi që QPS në Ferizaj nuk ka fëmijë për adoptim.
12. Më 24 prill 2012, QPS në Malishevë njofton (Njoftim nr. 30/1197) QPS në Ferizaj se kanë një fëmijë të gjinisë mashkullore për adoptim.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurë civile**

13. Më 21 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Komunale në Ferizaj, parashtrori propozim për adoptimin e fëmijës A. Z., i cili është në përkujdesjen e QPS në Malishevë.
14. Më 30 maj 2013, Gjykata Komunale në Ferizaj me Aktvendimin Nd. nr. 366/12 caktoi periudhën provuese prej 3 (tre) muajsh për themelimin e marrëdhënies së adoptimit, dhe obligoi QPS në Ferizaj që të mbikqyrë periudhën provuese prej 31 majit 2013 deri më 31 gusht 2013, pastaj t'i dorëzoi gjykatës në fjalë një raport të vlerësimit me shkrim.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurë përmbarimore**

15. Më 31 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrori propozim në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, për përmbarimin e Aktvendimit Nd. nr. 366/12, të Gjykatës Komunale të Ferizajt, pasi që QPS në Ferizaj nuk ia kishte dorëzuar fëmijën parashtruesit të kërkesës, për t'u realizuar periudha provuese sipas urdhërit të Gjykatës Komunale në Ferizaj.
16. Më 3 qershor 2013, Gjykata Themelore e Gjakovës - Dega në Malishevë nxori Aktvendimin E. nr. 724, me të cilin lejoi përmbarimin e propozuar nga parashtruesi i kërkesës.
17. Më 7 qershor 2013, QPS në Malishevë, ushtroi kundërshtim në Gjykatën Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë, kundër përmbarimit të Aktvendimit Nd. nr. 366/12 të Gjykatës Komunale të Ferizajt, me pretendimin se aktvendimi në fjalë është nxjerrë pa pëlqimin e kujdestarit ligjor dhe në kundërshtim me vlerësimet e QPS në Ferizaj dhe QPS në Malishevë.
18. Më 10 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë, ushtroi përgjigje në kundërshtim dhe propozoi që kundërshtimin e ushtroar nga QPS-të ta shpall të pabazuar, si dhe kërkoi zbatimin e përmbarimit të Aktvendimit Nd. nr. 366/12, të Gjykatës Komunale të Ferizajt.
19. Më 12 qershor 2013, Gjykata Themelore e Gjakovës - Dega në Malishevë (Aktvendimi E. nr. 724/13), aprovoi kundërshtimin e ushtroar nga QPS në Malishevë dhe vendosi të anuloi Aktvendimin E. nr. 724/13 të 3 qershorit 2013, me të cilin ishte lejuar përmbarimi i Aktvendimit Nd. nr. 366/12 të Gjykatës Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë.

20. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), kundër Aktvendimit E. nr. 724/13, të 12 qershorit 2013, të Gjykatës Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë, për shkak të shkeljeve të pretenduara të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.
21. Më 9 korrik 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, Ac. nr. 1802/2013) refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin E. nr. 724/13, të 12 qershorit 2013, të Gjykatës Themelore të Gjakovës - Dega në Malishevë.
22. Më 16 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi propozim për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit, kundër Aktvendimit Ac. nr. 1802 të Gjykatës së Apelit.
23. Më 26 korrik 2013, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KMLC. nr. 73/13) refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak se nuk kishte bazë ligjore të argumentueshme për ushtrimin e këtij mjeti juridik.
24. Më 19 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për rishikimin e propozimit për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë te Kryeprokurori i Shtetit.
25. Më 26 gusht 2013, Kryeprokurori i Shtetit njoftoi se qëndron pranë njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. 72/13, të 26 korrikut 2013.

### **Përmbledhja e fakteve përkitazi me përsëritjen e procedurës gjyqësore**

26. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për përsëritjen e themelimit të marrëdhënies së adoptimit në Gjykatën Themelore të Ferizajt.
27. Më 27 shtator 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj (Aktvendimi Nd. nr. 366/12), refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për themelimin e marrëdhënies së adoptimit përkitazi me fëmijën.
28. Më 11 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit Nd. nr. 366/12 të Gjykatës Themelore të Ferizajt për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
29. Më 12 shtator 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 3423/2013), refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin Nd. nr. 366/12, të 27 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore të Ferizajt.
30. Në Aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit arsyetoi se “... me dispozitën e nenit 179 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Familjen i Kosovës, ku i referohet banimit të përhershëm, në par 1 të tij, decidivisht thuhet: adoptues mund të jetë vetëm

*banori i përhershëm, pra fjala është për banorin rezident në Kosovë, (sepse asnjë person nuk mund të ketë banim të përhershëm në dy shtete në të njëjtën kohë), ndërkaq, në paragrafin 3 të të njëjtit nen thuhet: për adoptimin e fëmijës nga shtetasi i huaj nevojitet pëlqimi paraprak nga organi administrativ kompetent për punë e politikë sociale. [...] ndërsa edhe sikur propozuesit të jenë edhe shtetas të Kosovës, përsëri pëlqimi i kujdestarit, por edhe inicimi i procedurës, nëpërmjet tij, gjithsesi duhet të bëhet, ndërsa në rastin konkret as njëra nga këto nuk është zbatuar [...]” .*

31. Më 24 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit Ac. nr. 3423/2013 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
32. Më 6 janar 2015, Gjykata Supreme (Aktvendimi, Rev. nr. 341/2014), refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, dhe vërtetoi se në bazë të gjendjes faktike, gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar drejt kur kanë refuzuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për adoptimin e të miturit.
33. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi:

*“Qendra për punë sociale në Malishevë në raportin e saj... me shkrim nuk ka dhënë rekomandim gjykatës për adoptimin e të miturit. Me këtë nuk është plotësuar kushti i domosdoshëm nga neni 169.1 lidhur me nenin 171 të Ligjit për Familjen i Kosovës, pasi që mungon pëlqimi i kujdestarit të miturit.*

*Propozuesit kërkesën e kanë bërë në bazë të procedurave për adoptim si qytetarë të Kosovës e jo si persona jashtë Kosovës. Sipas dispozitave në fjalë ky Panel është formuar për adoptim jashtë Kosovës me qëllim të zbatimit edhe të Konventës së Hagës për të Drejtat e Fëmijëve me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve.*

*Thëniet në revizion se propozuesit janë shtetas të Kosovës janë të pabazuara nga fakti jo kontestues se propozuesit ... janë me qëndrim të përhershëm në RF të Gjermanisë që nga viti 1993, nga kjo del se fëmiju duhet të adoptohet jashtë Kosovës dhe se në rastin konkret adoptimi duhet t'i nënshtrohet procedurës së veçantë dhe është e domosdoshme mendimi i Panelit të veçantë për adoptim jashtë Kosovës e cila funksionon pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ...”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin, Rev. nr. 341/2014 të Gjykatës Supreme, dhe me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e garantuara sikurse janë përmendur në paragrafin 3, të këtij dokumenti.
35. Parashtruesi i kërkesës, për më tepër kërkon nga Gjykata që të zbatohet Aktvendimi, Nd. nr. 366/12, i 30 shtatorit 2013, i Gjykatës Komunale në Ferizaj,

me të cilin ishte aprovuar periudha provuese për themelimin e marrëdhënies së adoptimit.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

36. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

38. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

*[...]*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 341/2014, të 6 janarit 2015, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 1, 22, 37 dhe 50 të Kushtetutës, si dhe me nenin 3 të KDF-së.

40. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se me procedurat e përfunduara në gjykatat e rregullta, i janë shkelur dispozitat ligjore që e rregullojnë lëmin e familjes në Republikën e Kosovës.

41. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të dispozitave kushtetuese të lartpërmendura, Gjykata, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjesht deklaron se ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive të tij, pa shpjeguar si dhe pse faktet që ai paraqiti përbëjnë shkelje të atyre të drejtave.

42. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 3 të KDF-së, i cili përcakton:

*“1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat,*

autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërish të përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur”.

43. Megjithatë, Gjykata konsideron se, pavarësisht se parashtruesi i kërkesës i ngriti pretendimet për shkeljen e nenit 3 të KDF-së, ai më tutje nuk argumenton si dhe pse gjykatat e rregullta ia shkelën këtë të drejtë, duke ditur se ky nen është mjaft i përgjithësuar dhe përfshin një varg obligimesh dhe të drejtash që dalin nga konventa për shtetet kontraktuese.
44. Gjykata vëren se, Gjykata Supreme shqyrtoi secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës duke shpjeguar në mënyrë të detajuar, se përse është dashur që kërkesa e parashtruesit për revizion të refuzohet si e pabazuar, dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës së instancës më të ulët.
45. Gjykata bazuar në shkresat e lëndës, konsideron se Aktvendimi i Gjykatës Supreme nuk ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare, ashtu siç pretendon parashtruesi i kësaj kërkesë.
46. Përkitazi me pretendimet tjera që i takojnë gjendjes faktike dhe interpretimit të dispozitave të ligjit, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat apo autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
47. Gjykata gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28).
48. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
49. Gjykata më tej konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe ato në Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

50. Gjykata gjithashtu vëren se, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.
51. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij janë të padëshmuara dhe të pabazuara, prandaj kërkesa e tij duhet deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe d), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 30 tetor 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Artta Rama-Hajrizi